




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Gjakovës  
Opština Đakovica-Municipality of Gjakova



RRREGULLORE  
PËR  
ORARIN E PUNËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE  
NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Tetor 2019



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Gjakovës  
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova

Kuvendi i Komunës, Gjakovë

01 Nr. \_\_\_\_\_ /2019

Datë 31.10.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 12 (paragrafi 12.1 dhe 12.2, shkronja c) dhe nenit 40 (paragrafi 40.1 dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 18 (paragrafi 18.1 dhe 18.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjakovës dhe në mbështetje të nenit 40 të Ligjit Nr.2004/18 Për Tregtinë e Brendshme i ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-005 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 Për Tregtinë e Brendshme, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2019, pas diskutimeve lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: shqyrtimi i draftit rregullore për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në Komunën e Gjakovës, miratoj këtë:

## RREGULLORË PËR ORARIN E PUNËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

### Neni 1

#### Qëllimi

Kjo rregullore si qëllim primar ka përcaktimin e fillimit dhe mbarimit të orarit të punës, ditët në të cilat shitësi detyrohet të punojë dhe ditët kur nuk punohet për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës.

### Neni 2

#### Pushëveprimi

Me këtë rregullore përcaktohet orari i punës për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës, detyrat dhe obligimet e pronarëve dhe personave përgjegjës të shoqërive tregtare, mbikëqyrja inspektuese dhe masat tjera administrative.

### Neni 3

#### Përkufizimet

1. **Komuna**-Komuna e Gjakovës, siç është paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
2. **DPI**-Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
3. **DZHF**-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Gjakovës.

4. Veprimtari Ekonomike-Në kuptim të kësaj rregullore, veprimtari ekonomike do të thotë çdo lloj aktiviteti i rregullt ose i përsëritur i cili përfshin ofrimin, tregtimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave/produkteve, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për një person ose Shoqëri Tregtare, në këmbim ose në pritje të çfarëdo lloj pagese ose kompensimi.
5. Shoqëri Tregtare-Siç është paraparë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, e që përfshinë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.
6. Inspektor-Inspektori i Tregut.
7. Zyrtar i autorizuar-Nëpunësi civil i autorizuar nga udhëheqësi më i lartë administrativ i Gjakovës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore.
8. Rregullore-Rregullorja për orarin e punës së veprimtarisë ekonomike në Komunën e Gjakovës.
9. Lokal afarist-Çdo pronë e pa-luajtshme ku tregtari kryen veprimtarinë e tij në bazë të përhershme, ose hapësirë e lëvizshme afariste, ku tregtari kryen veprimtarinë e tij ekonomike.
10. Orari i punës-Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës, ditët në të cilat duhet të punohet dhe ditët kur nuk punohet për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës,

#### Neni 4

##### Respektimi i orarit të punës nga veprimtaritë ekonomike

1. Të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës janë të obliguara të përmbahen orarit të punës siç është përcaktuar me këtë rregullorë.
2. Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që të ushtrojnë veprimtarinë ekonomike sipas pëlqimit të dhënë nga DZHH.
3. Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos ndikojnë negativisht në prishjen e qetësisë së banorëve për tresh.
4. Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos bien ndesh me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike dhe Ligjin në fuqi për Mbrojtje nga Zhurma, si dhe aktet tjera nën ligjore që rregullojnë këtë fushë.
5. Të gjitha shoqëritë tregtare mund të shkurtojnë orarin e përcaktuar të punës të paraparë me këtë rregullorë. Për punën më të shkurter, për ditët kur nuk punohet, përveq njoftimit që duhet të vendoset në hyrje të lokalit afarist në vend të dukshëm, duhet të njoftojnë edhe inspektoratin e Tregut në Gjakovë.

## Neni 5

### Vendosja e orarit të punës

Të gjithë pronarët dhe personat përgjegjës të shoqërive tregtare janë të obliguar që në hyrje të lokalitë afarist në vend të dukshëm të vendosin orarin e punës siç është paraparë në këtë rregullore, duke përfshirë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, ditët kur nuk punohet, për punën me të shkurtër dhe kohën e pauzës në raste kur praktikohen.

## Neni 6

### Orari i punës sipas periudhave

Orari i punës është i njëjtë për të dyja periudhat, atë verore dhe dimërore:

## Neni 7

### Veprimtaritë ekonomike të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Prodhimit bimor dhe shtazor, kultivimi i bimëve njëvjeçare, i drithërave, i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore, i orizit, i perimeve, pjeprave dhe shulqirit, bimëve rrënjore dhe tuberoze, i duhanit, bimëve fibroze, bimëve të tjera njëvjeçare, i kulturave shumëvjeçare, hardhëve, agrumeve, frutave me bërthamë dhe frutave me furë, i frutave të tjera pemore, shkurteve dhe arrave, i frutave vajore, erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore dhe i bimëve të tjera shumëvjeçare. Shumimi i bimëve, rritja e gjedheve për qumësht, e gjedheve të tjera dhe buallicave, e kuajve dhe njëhundraqëve; e deleve dhe dhive, derrave, shpezëve dhe kafshëve të tjera. Veprimtaritë përkrahëse për bujqësinë, veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore dhe përpunimi i farërave për shumimin, është nga ora 08:00-22:00.

## Neni 8

### Veprimtaritë ekonomike të minierave dhe gurorëve (industria e nxjerrjes)

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Nxjerrjes së xehes së metalit, xehes së hekurit, xehëve të tjera jo-metalore. Xehorëve dhe gurorëve tjera, nxjerrjes së gurit, çrës dhe argjilës, e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, e gurit gëlqeror, e gjipsit, shkumësit dhe crasave, e zhavorrit dhe çrës, e mineraleve kimike dhe plehrave kimike si dhe veprimtarive të tjera nxjerrëse, është nga ora 08:00-22:00.

## Neni 9

### Veprimtaritë ekonomike të industrisë përpunuese

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Përpunimit të produkteve ushqimore, konservimi (ruajtja) e mishit dhe produkteve me bazë mishi, të mishit të shpezëve, i peshkut, krustaceve dhe molusqeve, i frutave dhe perimeve i patales, i vajrave dhe yndyrërave, i produkteve të drithërave, niseshtes dhe produkteve të niseshtes, i çajit dhe kafës, i erëzave dhe salcave, i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme, i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike, i ushqimeve të përgatitura për kafshë, i produkteve të tjera kimike me bazë organike, i plehrave kimike dhe

komponimeve të azolit. Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta, i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve, i margarinës dhe yndyrësve të tjera të ngjashme, i produkteve të qumështit, i akullores, i biskotave dhe galetave, i pastave dhe kekëve të konservuar, i makaronave, spagetave dhe produkteve të ngjashme nga miell, i sheqerit, i kakaos, çokollatës, ëmbëlsirave dhe i pijeve, verërave të tjera me bazë frutash, i pijeve të tjera të fermentuara të padestiluara, i birrës, i majës së birrës, i pijeve të ndryshme, i produkteve të duhanit, i tekstilit, i pëlhurave të thurura dhe të endura, i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve, i qilimave, síxhiadeve dhe tepihëve, i liturëve, spangove dhe trjetave, i pëlhurave të paendura, i veshjeve të tjera përveç veshjeve të gëzoftit, i valixhëve, çantave dhe gjësendëve të ngjashme, i këpucëve, i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, i letërës dhe produkteve prej letërës, kartonit, i tapetave të mureve, i produkteve kimike. Prodhimi i plastikës, i gomës sintetike, i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike, i ngjyrave, llaçeve dhe shtresave të ngjashme, i sapunit dhe detergjenteve, preparateve të pastrimit dhe lustrimit, parfumeve dhe preparateve të tualetit, i fibrave sintetike dhe artificiale, i produkteve me bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve, i produkteve të tjera të gomës, i produkteve minerale jometalike, i qelqit dhe produkteve prej qelqit dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi. Prodhimi i produkteve rezistuese ndaj zjarrit, i materialeve të ndërtimit prej argjilës, i tullave dhe tjegullave prej qeramike, i produkteve tjera nga porcelani dhe qeramika, i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues, i pajisjeve sanitare, i çimentos, gëlqerës dhe llaçit dhe i artikujve të betonit. Prodhimi i tubave, gypave, profiëve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku, prodhimi i metaleve të çmuara dhe metaleve jo-ferrike, i aluminit, i plumbit, zinkut dhe kallajit, i bakrit, i metaleve të tjera jo-ferrike, prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre, i dycerve dhe dritareve prej metali, mjeteve dhe pajisjeve të përgjithshme metalike, i thikave, i dorezave dhe cilindrave, i veglave, i produkteve të tjera prej metali, prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike, i përbërësve dhe pllakëzave elektronike, i produkteve elektronike për konsumatorë, i instrumenteve dhe pajisjeve të matjes, prodhimi i instrumenteve optike dhe pajisjeve fotografike, prodhimi i pajisjeve elektrike, i motorëve elektrikë, gjeneratorëve, i baterive dhe akumulatorëve, i telave dhe kabllave të izoluar, i kabllave të fibrave optikë, i telave dhe kabllave të tjera elektrike i pajisjeve elektrike të ndriçimit, i pajisjeve elektrike shtëpiake, i pajisjeve hidraulike, i pompave dhe kompresorëve të tjerë, veglave mekanike të dorës, i pajisjeve jo shtëpiake për ftohje dhe ventilim, i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm, i makinerive bujqësore dhe pyjore, i makinerive dhe veglave të makinave për punimin e metaleve, i veglave të tjera të makinave, i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit, i mjeteve motorike (të transportit), i biçikletave dhe karrocave për persona me nevoja të veçanta, i stolive të çmuara (argjendarisë), bizhuterive dhe artikujve të ngjashëm me to, i instrumenteve muzikore, i artikujve sportiv, i lojërave dhe lodrave, i instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare, i fshesave dhe furçave, prodhimi i jetër, Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve, i produkteve metalike të fabrikua, i pajisjeve elektronike dhe optike, i pajisjeve elektrike, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera të transportit dhe i pajisjeve të tjera. Instalimi i makinerive dhe pajisjeve

industriale. Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara. Veprimtaritë e shtypjes (printimit) dhe shërbimet e lidhura me shtypjen, shtypja e gazetave dhe shtypje të tjera, shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit, libërlihdhja dhe shërbime të ngjashme, riprodhimi i mediave të incizuara. Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare. Mbështjellja e flohtë e rripave të ngushtë. Formimi ose palosja e flohtë. Derdhja (fonderia) e metaleve, hekurit, çelikut, e metaleve të lehta, e metaleve të tjera jo-ferrike. Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; stampimi dhe palosja rrethore e metaleve dhe përpunimi mekanik, është nga ora 08:00-22:00.

#### **Neni 10**

##### **Veprimtaritë ekonomike të furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Energjisë elektrike, gazit dhe avullit, është nga ora 08:00-23:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkuara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### **Neni 11**

##### **Veprimtaritë ekonomike të furnizimit me ujë, kanalizim, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Furnizimit me ujë, kanalizimit, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe zgjedhimit të mbeturinave dhe rikuperimit të materialeve, është nga ora 08:00-23:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkuara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### **Neni 12**

##### **Veprimtaritë ekonomike të ndërtimitarisë**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Ndërtimit të ndërtesave; zhvillimi i projekteve të ndërtimit, ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, ndërtimi i rrugëve, hekurudhave, urave, ndërtimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve, ndërtimi i projekteve të tjera të ndërtimit civil dhe ndërtimi i projekteve të ujit. Demolimi dhe përgatitja e vend-punishites, demolimi i objekteve. Veprimtaritë elektrike, hidraulike, instalime të tjera të ndërtimit. Punime suvatimi, montimi nga druri dhe materiale të tjera. Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve, punimet e kulmit (çatisë), lyerja dhe vendosja e xhamave. Aktivitete të tjera të specializuara për ndërtim dhe veprimtarive tjera të specializuara ndërtimi, është nga ora 08:00-20:00.

### Neni 13

#### **Veprimtaritë ekonomike të tregtisë me shumicë, pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Tregtisë me shumicë dhe pakicë, si dhe riparimi e mirëmbajtja e automjeteve, motoçikletave, veprimtaritë e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë e pakicë, si dhe veprimtaritë e tjera të ndërmjetësimit për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash. Tregtia me shumicë e veturave dhe automjeteve, pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve, e lëndëve të para bujqësore dhe kafshëve të gjalla, e drithërave, duhanit të përpunuar, lëkurave dhe artikujve prej lëkure, e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, e frutave dhe perimeve, e mishit dhe produkteve të tij, ëmbëlsirave të ndryshme dhe e produkteve të tjerë ushqimorë përfshirë peshkun, pijeve dhe duhanit, e tekstileve, e veshjeve dhe këpucëve, e pajisjeve elektroshitëpiake, e porcelanit dhe artikujve të xhamit, e parfumerisë dhe kozmetikës, e produkteve farmaceutike, e kompjuterëve, pajisjeve dhe pjesëve të tjera të tyre, e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve furnizuese, e veglave të makinerive, e makinerive të minierave, të ndërtimit, si dhe për punime inxhinierike, e metaleve dhe mineraleve, e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare, e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit. Tregtia me pakicë ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani, frutat dhe perimet në dyqane të specializuara, mishit dhe produkteve të mishit, e peshkut, e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, e pijeve të ndryshme, e produkteve të duhanit, dhe produkteve të tjera ushqimore. Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, e kompjuterëve, njësisve periferike dhe softuerëve, e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara, e pajisjeve të tjera shitëpiake, e tekstileve, artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, veshjeve të mureve dhe dyshemeve, e pajisjeve, mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiakë, mallrave kulturore dhe të argëtimit, e librave, e gazetave dhe materialit të shkrimit, e pajisjeve sportive, e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara, e mallrave të tjerë, e veshjeve, këpucëve, tregtia me pakicë e produkteve farmaceutike (farmatore), e artikujve ortopedike dhe mjekësore, e artikujve kozmetike dhe të tualetit në dyqane të specializuara, e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkëdhetëse, e orëve dhe argjendarisë, e mallrave të përdorura dhe të reja tregtia me pakicë përmes tezgave dhe tregjeve të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, tregtia me pakicë në tezgë dhe tregje të produkteve tjera, tregtia me pakicë jo në dyqane, është nga ora 08:00-22:00.

### Neni 14

#### **Veprimtaritë ekonomike të transportit dhe magazinimit**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Transportit tokësor, magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport, është nga ora 07:00-23:00.

## Neni 15

### **Veprimtaritë ekonomike të akomodimit dhe shërbimit ushqimor**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Akomodimit (hotelet dhe akomodimi i ngjashëm, pushimet dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër, kampingjet, parqet me mjete rekreative dhe me rimorkio dhe akomodime të tjera. Veprimtaritë shërbyese të ushqimit dhe pijeve, restaurantet, kafenet dhe veprimtaritë shërbyese lëvizëse të ushqimit, furnizimi me ushqim me porosi për rastë, është nga ora 07:00-24:00.

## Neni 16

### **Veprimtaritë ekonomike të informimit dhe komunikimit**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Veprimtarive botuese, prodhimi i filmave, video dhe programeve televizive, incizimi i zërit dhe veprimtaritë e publikimit të muzikës. Veprimtaritë programore dhe të transmetimit, telekomunikimi, është nga ora 07:00-24:00.

## Neni 17

### **Veprimtaritë ekonomike financiare dhe të sigurimit**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Shërbimeve financiare, ndërmjetësimit monetar, veprimtaritë e tjera shërbyese financiare, veprimtaritë e tjera të kredisë dhe të tjera veprimtari shërbyese financiare, sigurimi jetësor dhe jo jetësor, aktivitet ndihmëse për shërbimet financiare dhe veprimtaritë e sigurimit, vlerësimi i riskut dhe dëmit, veprimtaritë e agjentëve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, është nga ora 08:00-16:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

## Neni 18

### **Veprimtaritë ekonomike të patundshmërive**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Patundshmërisë, blerja dhe shirja e patundshmërisë personale, qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira, aktivitete të pasurive të patundshme në bazë të pagesës ose kontratës, agjensitë e patundshmërive, menaxhimi i patundshmërisë në bazë të pagesës ose kontratës, është nga ora 08:00-16:00.

## Neni 19

### **Veprimtaritë ekonomike profesionale, shkencore dhe teknike**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Aktiviteteve juridike dhe të kontabilitetit, libërmbajtjes dhe auditimit, këshillime tatarore, veprimtaritë e udhëheqjes së ndërmarrjeve dhe veprimtaritë e konsultimit, veprimtaritë e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për menaxhim, veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë, veprimtaritë e specializuara të dizajnit, veprimtaritë e fotografimit, përkthimit dhe interpretimit, veprimtaritë e tjera profesionale dhe veprimtaritë e veterinarisë, është nga ora 08:00-20:00.

2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### **Neni 20**

##### **Veprimtaritë ekonomike të shërbimeve administrative dhe mbështetëse**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Qiradhënies dhe të lizingut, marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i automjeteve motorike, i artikujve personal dhe shtëpiak, rekreativ dhe sportiv, video-kasetave dhe disqeve, artikujve të tjerë personal dhe shtëpiak, makinerisë, pajisjeve dhe e mallrave të tjerë të luajtshëm, makinerisë dhe pajisjeve bujqësore, makinerisë dhe pajisjeve të ndërtimitarisë dhe inxhinierisë, makinerisë dhe pajisjeve të zyrave, makinerisë, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të luajtshëm. Aktivitet e agjensive të punësimit, sigurimi i burimeve njerëzore, agjensitë e udhëtimit, operatorët turistik dhe shërbimet e rezervimeve të tjera dhe veprimtaritë lidhur me to, veprimtaritë e sigurisë private, shërbimet e sigurisë me ndihmën e sistemeve të sigurisë. Veprimtaritë e tjera të pastrimit, aktivitete të shërbimit të mirëmbajtjes dhe të kujdesit të shesheve (mjedisit), mbështetja administrative dhe veprimtaritë e tjera mbështetëse të bizneseve, zyrat administrative dhe veprimtaritë mbështetëse, veprimtaritë e kombinuara shërbyese të administrimit të zyrave, përgatitja e dokumenteve dhe veprimtaritë e tjera të specializuara mbështetëse për zyrat, veprimtaritë e qendrave të thirrjeve, veprimtaritë e paketimit (ambalazhimit) dhe veprimtaritë e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve, është nga ora 08:00-20:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### **Neni 21**

##### **Veprimtaritë ekonomike të administrimit publik, mbrojtjes, sigurimit social dhe të detyrueshëm**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Administratës publike dhe mbrojtjes, sigurimi i detyrueshëm social dhe veprimtaritë e përgjithshme të administratës publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### **Neni 22**

##### **Veprimtaritë ekonomike të arsimit**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Arsimit parashkollor, arsimit fllor, arsimit të mesëm, arsimit të mesëm teknik dhe profesional, arsimit për sporte dhe rekreacion, arsimit kulturor, aktivitetet e autoshkollave, është nga ora 08:00-23:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

## Neni 23

### **Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale**

1. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: shëndetit të njeriut, të spitaleve, të praktikës së mjekëve dhe dentistëve, të mjekësisë së praktikës së përgjithshme, të mjekësisë së specializuar, e dentistëve, veprimtaritë e tjera të shëndetit të njeriut, veprimtaritë e kujdesjes në shtëpi, kujdesjes infermierike në shtëpi, veprimtaritë në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, veprimtaritë e kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, është nga ora 07:00-24:00.
2. Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni e që janë publike, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

## Neni 24

### **Veprimtaritë e arteve, argëtimit dhe rekreacionit**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Krijuesëve, artistike dhe argëtuese, shfaqjet artistike, veprimtaritë mbështetëse për shfaqje artistike, funksionimi i objekteve të artit, bibliotekat, muzetë dhe veprimtaritë e tjera kulturore, arkivat, muzetë dhe veprimtaritë e tjera kulturore, funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike, si dhe i atraksioneve të ngjaslme për vizitorë, veprimtaritë e lojërave të fatit dhe basteve, veprimtaritë sportive, argëtuese dhe veprimtaritë e rekreacionit, veprimtaritë e klubeve sportive, palestrat e fitnesit, veprimtaritë e tjera të argëtimit dhe rekreacionit, është nga ora 07:00-24:00.

## Neni 25

### **Veprimtaritë tjera shërbuese**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve dhe shoqatave profesionale, riparimi i kompjuterëve dhe artikujve të tjerë personal dhe shtëpiak, riparimi i pajisjeve elektronike të konsumit, riparimi i pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve për shtëpi dhe të kopshtarisë, i këpucëve dhe artikujve prej lëkurës, i mobilieve dhe orndive shtëpiake, i orëve të dorës dhe argjendarisë, veprimtaritë e tjera shërbuese si larja, lustrimi, tharja e tekstileve dhe produkteve të gëzofit, sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë dhe veprimtaritë e mirëmbajtjes trupore, është nga ora 08:00-22:00.

## Neni 26

### **Veprimtaritë e ekonomive familjare si punëdhënës, mallra dhe shërbime të padiferencuara, veprimtaritë e ekonomive familjare për përdorim vetanak**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Ekonomive familjare si punëdhënës të personelit vendor, aktivitetet e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme të familjeve për përdorim vetanak, është nga ora 08:00-23:00.

#### Neni 27

##### **Veprimtaritë e trupave dhe organizatave udërkombëtare**

Orari i punës për veprimtaritë ekonomike të: Trupave dhe organizatave udërkombëtare, rregullohen me dispozita tjera ligjore.

#### Neni 28

##### **Veprimtaritë tjera ekonomike**

Për ato veprimtari ekonomike të cilat nuk janë përshkruar në këtë rregullore, orari i punës është i njëjti me ato veprimtari në të cilat bëjnë pjesë, varësisht se në cilin sektorë bëjnë pjesë, duke ju referuar Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike Nac Rev.2.

#### Neni 29

##### **Pëlqimi për zgjatje të orarit të punës**

1. Për punën më të gjatë se orari i punës i paraparë me këtë rregullore, duhet të merret pëlqim paraprak nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës.
2. DZHE mund të leshoj pëlqim për zgjatje të orarit të punës deri në ora 02:00 pas mesnate, pasi të jenë plotësuar kriteret e para.
3. Veprimtaritë ekonomike të tregtisë me pakicë të karburantit për automjete (pompat e benzinës), tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik (farmatore), veprimtaritë e shëndetit të njeriut, tregtia me pakicë dhe prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta (furrat e bukës), tregtia me pakicë dhe prodhimi i akullores dhe ëmbëlsirave (ëmbëltoret), sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë, shërbimet funerale dhe veprimtaritë e lidhura me to, aktivitetet e sigurisë private duke përfshirë shërbimet e sigurisë me ndihmën e sistemeve të sigurisë, veprimtaritë ekonomike të akomodimit (Hotelet dhe Motelet-vetem me shërbim të ljetjes), veprimtaritë ekonomike të përshkruara në nenin 10 (paragrafi 1), 11 (paragrafi 1), 14, 16, 23 (paragrafi 1) si dhe veprimtaritë tjera për të cilat nuk është paraparë orari i punës me këtë rregullore, mund të punojnë edhe pas orës 02:00 pas mesnate me pëlqim paraprak të DZHE-së.
4. Kërkesa për zgjatje të orarit të punës duhet të parashtrohet në DZHE së paku 48 orë më parë, në ditët zyrtare të punës.
5. DZHE është e obliguar që brenda 74 orësh të leshoj vendim përmes së cilit refuzon ose aprovon kërkesën për zgjatje të orarit të punës.
6. DZHE mban të drejtën e tërheqjes/revokimit të pëlqimit për zgjatje të orarit të punës kur prishet rendi dhe qetësia publike, kur ka ankesa të banorëve për rreth apo kur ka ndotje akustike/zhurma që prishin qetësinë publike.

### Neni 30

#### Procedura e ankesës kundër vendimit të DZHE

1. Kundër vendimit të DZHE-së lejohet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike, e cila i drejtohet komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Gjakovës.
2. Parashtrimi i ankesës kundër vendimit të DZHE-së nuk e ndalon ekzekutimin e tij.
3. Komisioni prej tre anëtarësh i propozuar nga Drejtori i DZHE-së dhe i miratuar nga udhëheqësi me i lartë administrativ i Komunës së Gjakovës, është i detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ankesës të vendos për ankesën e ushtruar kundër vendimit të DZHE-së.
4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

### Neni 31

#### Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për zgjatje të orarit të punës

1. Plotësimi i formularit zyrtar për zgjatje të orarit i cili duhet të dorëzohet në arkivin e komunës së Gjakovës.
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të shoqërisë tregtare (biznesit).
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit të shoqërisë tregtare.
4. Pëlqimi i Inspektoratit mbi plotësim të kushteve minimale higjieno-teknike dhe sanitare.
5. Për aktivitetet e organizuara në sipërfaqe publike duhet pëlqimi nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për shfrytëzim të përkohshëm të sipërfaqes publike.
6. Vërtetimi i tatimit në pronë për pronën në të cilën ushtron veprimtarinë e saj shoqëria tregtare.
7. Dëshimi e pagesës për zgjatje të orarit të punës.
8. DZHE mban të drejtën e kërkimit të dokumenteve, pëlqimeve shtesë kur kjo është e arsyeshme.

### Neni 32

#### Pagesa për zgjatje të orarit të punës

Pagesa për zgjatje të orarit të punës është e përcaktuar me rregullore tjetër komunale.

### Neni 33

Njoftimi për pëlqim apo refuzim të kërkesës për zgjatje të orarit të punës  
DZHF: është e obliguar që brenda ditës kur nxirret pëlqimi apo refuzimi për zgjatje të orarit të punës të njoftoj DPI-në dhe Policinë e Kosovës-Stacionin Policor në Gjakovë.

### Neni 34

#### Obligimi për të ushtruar veprimtarinë

1. Veprimtaritë ekonomike si: Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik (Barnatore), të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në afërsi deri në 300 metra në rrugë tokësore më të shkurtër nga hyrja kryesore e Spitalit Rajonal të Gjakovës, janë të obliguara të punojnë çdo ditë të javës si dhe në ditët e festave zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Veprimtaritë ekonomike të përshkruara në paragrafin 1 të kësaj rregullore, janë të obliguara që në harmoni me planin për kujdestari të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Gjakovës të përcaktojnë me rotacion kujdestarinë (punën nga ora 22:00-08:00) si dhe punën gjatë festave zyrtare.
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Gjakovës është e obliguar të publikoj në web faqen e Komunes së Gjakovës orarin e kujdestarisë.
4. Veprimtaritë e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, lirohen nga pagesa për zgjatje të orarit të punës.

### Neni 35

#### Pushimi për-festa

1. Të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës, nuk ju lejohet ushtrimi i veprimtarisë për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Drejtoria për Punë Inspektuese është e obliguar që së paku 5 ditë para festës të njoftoj përmes web faqes së Komunës Gjakovës shoqëritë tregtare për datën dhe ditën se kur duhet të pushohet. Dite pushimi do të jete dita e pare e festes.
3. Përfshitim nga paragrafi 1 i këtij neni bëjnë këto veprimtari ekonomike: tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik në dyqane të specializuara (Barnatore), tregtia me pakicë dhe prodhimi i akullores dhe ëmbëlsirave (ëmbëlloret), tregtia me pakicë dhe prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta (furrat e bukës), tregtia me pakicë e karburantit për automjete (pompat e benzines), tregtia me pakicë në tregje (të autorizuara nga Komuna e Gjakovës) e produktëve ushqimorë dhe jo ushqimorë, shërbimet funerale dhe veprimtaritë e lidhura me to, veprimtaritë ekonomike të akomodimit, aktivitetet shërbyese të pijeve (hotelët, restorante, kampingjet, akomodime tjera, baret, kafencet, tavernat, diskotekat), aktivitetet e sigurisë

privato duke përfshirë shërbimet e sigurisë me ndihmën e sistemeve të sigurisë, veprimtaritë tjera të cilat janë paisur me pajisje për zgjatje të orarit të punës nga DZHE, si dhe veprimtaritë tjera për të cilat nuk është paraparë orari i punës me këtë rregullore.

4. Shoqëritë tregtare me veprimtari ekonomike: tregti me pakicë e mishit të freskët (mishtoret), tregtia me shumicë e mishit të freskët (thetoret) dhe tregtia me pakicë e gazetave ditore mund të punojnë në ditët e festave zyrtare të Republikës së Kosovës vetëm nga ora 07:00-10:00.

#### **Neni 36**

##### **Vendosja e flamurit**

Të gjithë pronarët e shoqërive tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Gjakovës janë të obliguar që në lokalin afarist në të cilin ushtrojnë veprimtari e tyre, çdo 17 Shkurt dhe 28 Nëntor të vendosin flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës dhe atë kombëtar (të Shqipëtarëve).

#### **Neni 37**

##### **Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj rregullore**

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore e bën Drejtoria për Punë Inspektuese përmes inspektorëve kompetent.
2. Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit dhe zyrtarët tjerë kompetent do të mbikëqyrin dispozitat ligjore në fuqi për sa i përket zburmës dhe ndikimit negativ në mjedis.

#### **Neni 38**

##### **Inspektimi**

1. Inspektori kryen inspektim sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesës së palës së tretë.
2. Inspektori është i detyruar që të informojë parashtruesin e ankesës lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarra brenda tetë (8) ditësh kalendarike.
3. Inspektori mund ta konstatoj gjendjen faktike me procesverbal, përmes fotove dhe incizimeve dixhitale, faturave/kuponëve fiskal si dhe informatave tjera të besueshme.
4. Inspektori në çdo kohë mund të ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë dhe mbyll lokalin afarist në të cilin ushtrohet veprimtaria ekonomike në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.
5. Elementet formalo-juridike që duhet t'i përmbaj akti juridik që e lëshon inspektori, janë të përcaktuara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

#### Neni 39

##### **Fillimi i procedurës ndëshkuese**

1. Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, inspektori dhe zyrtari i autorizuar mundet që brenda tetë (8) ditësh kalendarike nga dita e konstatimit të shqipton gjobë.
2. Nëse subjekti i gjobitur e bën pagimin e gjobës, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Inspektori, lirohet nga pagesa prej 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.
3. Në rast se subjekti i gjobitur nuk e paguan gjobën brenda afatit të dhënë, inspektori brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm ka të drejtë të filloj edhe procedura tjera administrative për inkasimin e gjobës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Inspektori kur konstaton se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, brenda tetë (8) ditësh kalendarike mund të paraqet kërkesë për fillim të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente, kur kjo është e paraparë me ligje të veçanta.
5. Vendimi apo urdhëresa përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### Neni 40

##### **Dispozitat ndëshkuese**

1. Personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik gjobitet me gjobë nga njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se njëmijë (1.000) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personin fizik që ushtron biznes individual gjobitet me gjobë nga pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se njëmijë e pesëqind (1.500) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore.
3. Personi juridik gjobitet me gjobë nga njëqind (100) euro, dhe jo me shumë se dymijë (2.000) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore.

#### Neni 41

##### **Procedura ankimore**

1. Procedura e ankesës kundër vendimit të Inspektorit është e përcaktuar me Ligjin për Tregtinë e Brendshme dhe Ligjin për Inspektoratin e Tregut.
2. Parashtrimi i ankesës kundër vendimit të Inspektorit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

#### Neni 42

##### Shtojta e kësaj rregullore

Për nevoja të sqarimit të veprimtarive ekonomike të paraparë me këtë rregullore duhet të referohet Vendimit të Qeverisë me Nr.04/123 i datës 05.04.2013 (Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike Nac Rev.2).

#### Neni 43

##### Mbledhja e mjeteve

Mjetet e mbledhura nga zbatimi i kësaj rregullore derdhen në Buxhetin e Komunës së Gjakovës.

#### Neni 44

##### Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr.110/04-16337 e datës 06.07.2017 për orarin e punës së veprimtarive afariste dhe OJQ-ve në Komunën e Gjakovës.

#### Neni 45

##### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Gjakovës.



Kryeshtetari i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Anton Shala